

Në bazë të nenit 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 10 / 16 gusht 2010), nenit 18 dhe nenit 23 të Ligjit Nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale në Kosovë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 10/8 maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 janar 2022, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR TRANSFERET DHE PAGESAT E TRANSFERIT TË MJETEVE PENSIONALE

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është të përcaktojë kushtet dhe kërkesat procedurale për transferim të mjeteve pensionale në ndonjë entitet tjetër pensional dhe mënyrën e pagesës së transfereve të tilla, në pajtueshmëri me udhëzimet e pjesëmarrësve apo përfituesve.
2. Kjo Rregullore zbatohet për Fondet Plotësuese Pensionale të Punëdhënësit (“Fondet Pensionale”) për Ofruesit e Pensioneve që ofrojnë Pensione Plotësuese Individuale (“Ofruesi i Pensioneve”) dhe ndaj pjesëmarrësve dhe përfituesve të Fondeve Pensionale dhe Ofruesve të Pensioneve të tilla. Kjo Rregullore gjithashtu zbatohet ndaj Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) deri në atë shkallë ku FKPK është fond që pranon transferin e përfituesit.

Neni 2

Përkufizimet

1. Të gjithë termat në këtë Rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përcaktuar në nenin 1 të Ligjit nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës dhe Ligjit nr.04/L-168 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës (në vijim: Ligji për Fondet Pensionale) dhe/ose me përkufizimet si më poshtë për qëllimin e kësaj Rregullore:
 - 1.1. **Pensioni i shtyrë** – nënkupton përfitimin pensional për të cilin pjesëmarrësi ka të drejtat e fituara me ndërprerjen e punësimit para moshës së pensionit, mirëpo kur ky përfitim është shtyrë deri në moshën e pensionimit.
 - 1.2. **Entiteti pensional** – i referohet Fondit të Pensioneve ose Ofruesve të Pensioneve, ose Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, sipas kontekstit përkatës.
 - 1.3. **Përfundimi i marrëdhënies së punës** – nënkupton ndërprerjen ose përfundimin e marrëdhënies punëdhënës–i/e punësuar, e cila është bazë për pjesëmarrjen e një individi në Fondin Pensional, për çfarëdo shkakut tjetër, nga pensionimi, kualifikimi i invaliditetit ose vdekja.

- 1.4. **Të drejtat e fituara për përfitimin e pensionit** – nënkupton të drejtat e pjesëmarrësit në pensionin me shuma të caktuara, vlera/shuma si e drejtë e fituar e cila është vlerë e mjeteve pensionale në llogarinë individuale të asaj/atij.

Neni 3

Kriteret për transferet prej Fondit Plotësues Pensional të Punëdhënësit (Fondi Pensional)

1. Fondi Pensional në aktin normativ të pensionit duhet të përcaktojë kriteret që i sigurojnë pjesëmarrësit të drejtën e transferit të të drejtave të fituara në përfitimin e pensionit të asaj/atij në rrethanat si vijim:
 - 1.1. Përfundimi i punësimit.
 - 1.2. Likuidimi ose falimentimi i punëdhënësit.
 - 1.3. Shuarja, likuidimi dhe pezullimi i Fondit Pensional.
 - 1.4. Ndryshimi në kategorinë profesionale të pjesëmarrësit, në rast se punëdhënësi ka vendosur rregullim specifik të kushteve të pensionit ose Fond Pensional për kategoritë e ndryshme profesionale për të punësuarit e tij.
2. Rregullativa për pensione që ofron pensionin me shuma të caktuara duhet të përfshijë Tabelën e Përfitimeve të Pensioneve, që prezantojnë periudhat specifike të pjesëmarrjes. Vlera/shuma e përfitimeve pensionale në fund të çdo periudhe duhet kualifikuar si e drejtë e fituar. Vlera/shuma si e drejtë e fituar mund të zbritet në shumën e tarifës e vendosur nga Ofruesit e Pensioneve, nëse janë plotësuar kërkesat si në vijim:
 - 2.1. Për pjesëmarrësin i cili e ndërpreu pagesën e kontributeve, të drejtat e fituara në Fondin Pensional mbesin si pension i shtyrë. Pagesa e pensionit fillon në moshën e pensionit. Nëse një individ i cili ka pension të shtyrë vdes para fillimit të pagesës së pensionit, përfitimet e pensionit të shtyrë do të paguhen në pajtim me rregulloret e pensionit, duke respektuar të drejtat e pjesëmarrësit në rast të vdekjes në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 4

Procedurat për kryerjen e transfereve të përfitimeve të pensioneve

1. Në mënyrë që të kryhet transferi i mjeteve pensionale prej Fondit Pensional (transferuesi) në një Fond tjetër Pensional, Ofrues të Pensionit ose në FKPK (pranuesi i transferit) duhet të përmbushen kërkesat si në vijim:
 - 1.1. Çdo Fond Pensional ose Ofrues i Pensionit që sponsoron marrëveshjen e pensionit duhet, në aktet normative të pensionit ose rregulloret e pensionit, të përcaktojë kushtet për regjistrimin ose pjesëmarrjen në rregullimin(et) e tyre pensionale. Për regjistrimin e pjesëmarrësve duhet të zbatohen procedurat si në vijim:
 - 1.1.1. Regjistrimet ose format e pjesëmarrjes duhet të jenë në dispozicion në entitetin pensional për të gjithë pjesëmarrësit e propozuar që ti plotësojnë dhe nënshkruajnë.
 - 1.1.2. Aprovimi i regjistrimit të propozuar ose pjesëmarrjes nga entiteti pensional që e pranon transferin, autorizon fillimin e kontributeve të pensioneve.

- 1.1.3. Pranimi në entitetin pensional i kontributit të parë të pensionit për llogarinë e individit plotëson pjesëmarrjen e asaj/atij në programin e pensionit.
- 1.2. Çdo transfer i mjeteve pensionale kërkon njoftim paraprak me shkrim të nënshkruar nga pjesëmarrësi dhe dërguar edhe te Fondi Pensional që kryen transferin.
 - 1.2.1. Njoftimi me shkrim duhet të jetë konform me kërkesat si në vijim:
 - 1.2.1.1. Entiteti pensional që pranon transferin duhet t'i sigurojë pjesëmarrësit formularin e njoftimit. Formulari duhet të kërkojë informata të tilla që kërkohen nga Entiteti Pensional që e pranon transferin për të regjistruar pjesëmarrësin, përfshirë këtu edhe informatat mbi përfituesin.
 - 1.2.1.2. Pjesëmarrësi duhet të plotësojë dhe nënshkruajë formularin e njoftimit.
 - 1.2.1.3. Nënshkrimi i një zyrtari të entitetit pensional që pranon transferin është dëshmi e pranimit të regjistrimit të propozuar të pjesëmarrësit në entitetin pensional që pranon transferin.
 - 1.2.1.4. Fondi Pensional që bën transferin pranon njoftimin.
 - 1.2.2. Pjesëmarrësi ka obligim që të njoftojë Fondin Pensional që bën transferin, për transferin e mjeteve pensionale të asaj/atij. Njoftimi mund të dërgohet në çdo kohë:
 - 1.2.2.1. Me përfundimin e punësimit, të drejtat e fituara të punonjësit që ka ndërprerë marrëdhënien e punës duhet të konsiderohet si pension i shtyrë deri sa ajo/ai të dërgon njoftimin në pajtueshmëri të plotë me këtë Rregullore.
 - 1.2.2.2. Në raste të likuidimit ose falimentimit të punëdhënësit, organet më të larta drejtuese të punëdhënësit kanë detyra fiduciare që të njoftojnë Fondin Pensional dhe Fondi Pensional ka detyrë fiduciare të njoftojë pjesëmarrësit për falimentimin e punëdhënësit sa më shpejtë kur një gjendje e tillë bëhet e njohur apo ekziston perceptimi i besueshëm për këtë gjendje nga organet drejtuese. Gjithashtu, organi më i lartë i punëdhënësit ka obligim fiduciar për njoftimin e Fondit Pensional, dhe Fondi Pensional ka obligim që të informojë pjesëmarrësit për çdo dështim të punëdhënësit për të paguar kontributet pensionale në pajtim me kontratën e punësimit në pajtim me aktet normative të pensionit. Gjithashtu, Fondi Pensional ka për detyrë që të njoftoj pjesëmarrësit dhe të paguajë kontributet pensionale sikur që kërkohet me kontratat e aplikueshme të punësimit ose marrëveshjeve kolektive në pajtueshmëri me dispozitat e rregullatIVES së BQK-ës për pensione .
 - 1.2.2.3. Gjatë shuarjes ose likuidimit të Fondit Pensional, Menaxhuesi i Posaçëm (Special) ose Bordi i Drejtorëve në pajtim me rregullativën e BQK-së në fuqi mbi shuarjen e Fondit Plotësues Pensional të punëdhënësit, duhet të ndjek procedurat për shuarjen, likuidimin dhe shpërndarjen e mjeteve pensionale.
 - 1.2.2.4. Në çdo kohë, në rast të ndryshimit në kategori të profesionit të pjesëmarrësit kur Fondet e veçanta të Pensionit janë siguruar për kategoritë e ndryshme të profesionit brenda të të njëjtit punëdhënës.
- 1.3. Fondi transferues i Pensionit duhet të bëjë pagesën e transferit të mjeteve pensionale në pajtim me udhëzimet si në vijim:

- 1.3.1. Pagesat e transferit duhet të bëhen drejtpërdrejt në entitetin pensional që pranon transferin sipas njoftimit me shkrim të përshkruar në nën paragrafin 1.2 të këtij neni.
- 1.3.2. Pagesa e transferit duhet të bëhet jo më vonë se 10 ditë prej datës së pranimit të njoftimit nga Fondi Pensional transferues.
- 1.3.3. Fondi Pensional që transferon duhet, për kryerjen e pagesës së transferit, të njoftojë pjesëmarrësin për një transfer të tillë. Entiteti pensional që pranon transferin duhet gjithashtu të njoftohet, në përputhje me rrethanat, nëse ndonjë pjesë e mjeteve pensionale të transferuara është favorizuar me ndonjë lirim nga taksa ose tjetër ngarkesë fiskale, duke përshkruar natyrën dhe vlerën e lirimeve të tilla.
- 1.3.4. Pjesëmarrja e të punësuarve që kanë ndërprerë marrëdhënien e punës, në Fondin Pensional që bënë transferin, ndërprehet në ditën e dhjetë (10) nga pranimi i njoftimit me shkrim të asaj/atij nga Fondi pranues Pensional, duke siguruar se kërkesat e përshkruara në nën paragrafin 1.2. të këtij neni janë përmbushur.

Neni 5

Kushtet dhe kriteret për transferet e Pensionit Plotësues Individual (Ofruesi i Pensionit)

1. Pjesëmarrësit kanë të drejtën e fituar që të transferojnë “Të Drejtat e Fituara” të tyre në mjetet pensionale të tyre në rastet si vijim:
 - 1.1. Me kërkesën e pjesëmarrësit.
 - 1.2. Likuidimin ose falimentimin e Ofruesit të Pensionit.
 - 1.3. Shuarja dhe likuidimi i programit të pensionit.
2. Vlera/shuma e përfitimeve pensionale duhet kualifikuar si “Të Drejta të Fituara” për mjetet pensionale referuar në paragrafin 1 të këtij neni, ashtu siç është përcaktuar në rregulloret përkatëse të BQK-së për pensione, si dhe përcaktuar në pajtim me Rregulloren e BQK-së për përfitimet pensionale nga pensionet plotësuese individuale.
3. Pjesëmarrësit kanë të drejtë për të suspenduar ose ndërprerë kontributet për programin e pensionit, duke i lejuar asaj/atij t’i lë të drejtat e fituara si pension i shtyrë. Dispozitat e pensioneve duhet të definojnë qartë termat dhe kushtet të aplikueshme në pensionet e tilla të shtyra. Pjesëmarrësi mundet në pajtim me këtë Rregullore, të transferoj në çdo kohë të drejtat e tij apo të asaj për pension të shtyrë.

Neni 6

Procedurat për kryerjen e transfereve të Mjeteve Pensionale

1. Në mënyrë që të kryhet transferi i mjeteve pensionale prej Ofruesit të Pensionit që bënë transferin në një entitet tjetër pensional që pranon transferin duhet të plotësohen kërkesat si në vijim:
 - 1.1. Çdo Fond Pensional ose Ofruesi i Pensionit që sponsoron rregullimet pensionale duhet në aktet normative të pensionit ose në rregulloret e pensionit të tyre, të themelojë termat dhe kushtet për regjistrim ose pjesëmarrje në rregullimin(et) e tyre pensionale. Për t’i regjistruar pjesëmarrësit duhet zbatuar procedurat si vijim:
 - 1.1.1. Regjistrimi ose forma e pjesëmarrjes duhet të jenë në dispozicion për të gjithë pjesëmarrësit e propozuar që t’i plotësojnë dhe nënshkruajnë.

- 1.1.2. Aprovimi i regjistrimit të propozuar ose pjesëmarrjes nga entiteti pensional që pranon transferin autorizon fillimin e kontributeve të pensionit.
 - 1.1.3. Pranimi i kontributit të parë të pensionit nga entiteti pensional për llogarinë e një individi që përfundon pjesëmarrjen, sipas paragrafit 1 të këtij neni, e asaj/atij në programin e pensionit.
2. Çdo transfer i mjeteve pensionale kërkon njoftim paraprak me shkrim, të nënshkruar nga pjesëmarrësi dhe dërgim te Ofruesi i Pensionit transferues.
 - 2.1. Njoftimi me shkrim duhet të jetë në pajtueshmëri me kërkesat si në vijim:
 - 2.1.1. Fondi Pensional që pranon transferin ose Ofruesi i Pensionit duhet t'i sigurojë pjesëmarrësit formularin e njoftimit. Formulari duhet të përmbajë kërkesën për informata të tilla që mund të kërkohen nga entiteti pensional që pranon transferin për të regjistruar pjesëmarrësin.
 - 2.1.2. Pjesëmarrësi duhet të plotësoj dhe nënshkruaj njoftimin.
 - 2.1.3. Nënshkrimi i një zyrtari të Fondit Pensional që pranon transferin ose Ofruesi i Pensionit është dëshmi e regjistrimit të pjesëmarrësit të propozuar në Fondin Pensional që pranon transferin ose Ofruesit të Pensionit.
 - 2.1.4. Ofruesi i Pensionit që bën transferin e pranon njoftimin.
3. Pjesëmarrësi ka për detyrë të njoftojë Ofruesin e Pensionit që bën transferin për transferin e mjeteve pensionale të asaj/atij. Njoftimi mund të dërgohet në çdo kohë me kërkesën e pjesëmarrësit, dhe:
 - 3.1. Gjatë likuidimit, falimentimit ose likuidimit të detyruar, në rast të likuidimit ose falimentimit të Ofruesit të Pensionit. Organet më të larta të qeverisjes së Ofruesit të Pensionit kanë detyrë fiduciare të njoftojnë pjesëmarrësin për një falimentim të pashmangshëm të Ofruesit të Pensionit në momentin që kjo të bëhet e njohur ose të kuptohet nga këto organe ose ndonjë prej anëtarëve të tyre.
 - 3.2. Gjatë ndërprerjes ose likuidimit të programit të pensionit në pajtim me planet e deklaruara nga Menaxheri Special, Likuidatori ose Bordi i Drejtorëve i cili në pajtim me rregulloret e aplikueshme bankare dhe të sigurimit dhe/ose rregullativën e BQK-së në fuqi, është i ngarkuar me ndërprerjen e programit të pensionit dhe/ose likuidimin dhe shpërndarjen e mjeteve pensionale.
 - 3.3. Në çdo kohë, në rast të ndryshimit në kategorinë e profesionit të pjesëmarrësit kur skemat e veçanta të Pensionit ofrohen nga Ofruesi i Pensionit për kategoritë e ndryshme të profesionit.
4. Ofruesi i Pensionit që bën transferin duhet të bëjë pagesën e transferit të mjeteve pensionale në pajtueshmëri me udhëzimet si në vijim:
 - 4.1. Pagesat e transferit duhet të kryhen drejtpërdrejt në Fondin Pensional që pranon transferin ose tek Ofruesi i Pensionit sipas njoftimit me shkrim të përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni.
 - 4.2. Pagesa e transferit duhet të bëhet jo më vonë se 10 ditë prej datës së njoftimit që është pranuar nga Ofruesi i Pensionit që bën transferin.
 - 4.3. Fondi Pensional që transferon duhet, për kryerjen e pagesës së transferit, të njoftojë pjesëmarrësin për një transfer të tillë. Entiteti pensional që pranon transferin duhet gjithashtu të njoftohet, në përputhje me rrethanat, nëse ndonjë pjesë e mjeteve pensionale të transferuara

është favorizuar me ndonjë lirim nga taksa ose tjetër ngarkesë fiskale, duke përshkruar natyrën dhe vlerën e lirimeve të tilla.

- 4.4. Pjesëmarrja e një individi në programin e pensionit të Ofruesit të Pensionit që bënë transferin ndërprehet në ditën e dhjetë (10) nga pranimi i njoftimit me shkrim, të asaj/atij nga Ofruesi i Pensionit që bënë transferin, duke siguruar se kërkesat e përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni janë në pajtueshmëri.

Neni 7

Kushtet dhe kriteret për transferet në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK)

1. Vetëm pjesëmarrësit të cilët ende nuk e kanë arritur moshën 65 vjeçare kanë të drejtë të zgjedhin FKPK i cili do të jetë fond që pranon transferin për mjetet pensionale që mbahen në Fondin Pensional ose në Ofruesin e Pensionit.
2. Mjetet pensionale të pjesëmarrësve të transferuara në FKPK duhet të transferohen në llogaritë individuale ekzistuese, nëse pjesëmarrësit e tillë veç marrin pjesë në FKPK. Transferi duhet të raportohet në pasqyrën e ardhshme të rregullt të siguruar nga FKPK. Nëse pjesëmarrësi nuk e ka llogarinë individuale ekzistuese, llogaritë e tilla individuale duhet të krijohen nga FKPK-ja.
3. FKPK-ja duhet t'u ofrojë, pjesëmarrësve që transferojnë mjetet e tyre pensionale në FKPK të njëjtat kushte siç iu ofrohen pjesëmarrësve të tjerë ekzistues. FKPK duhet të ofrojë mundësi të njëjta të pagesës sikurse pjesëmarrësve të tjerë me të njëjtat kushte, të tilla si pagesat e plota "lump sum", pagesat në faza ose anuitete.

Neni 8

Zbatimi, masat korigjuese dhe dënimet civile

Shkeljet e dispozitave të kësaj Rregulloreje do të jetë subjekt i masave të parashikuara sipas Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës si dhe Ligjit për Fondet Pensionale të Kosovës.

Neni 9

Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje do të shfuqizohet Rregulla 20 e miratuar më 16 mars 2006, mbi Ndryshimin e Rregullës mbi Transferet dhe Pagesat e Transferit të mjeteve të Pensionit të datës 23 tetor 2002.

Neni 10

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data e miratimit të saj.

Flamur Mrasori

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës